

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2026

Periudha (Prill 2026 )

Nr . Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfund imit të kërkesës	Tarifa
03	01.04.2026	<p>1.Numrin aktual të mjeteve zjarrfikëse në dispozicion të bashkisë, të ndara në funksionale dhe jashtë funksionit.</p> <p>2.Numrin e mjeteve zjarrfikëse të shtuara nga vera 2025 deri më sot, si dhe numrin e mjeteve në proces blerjeje ose prokurimi.</p> <p>3.Vitin e prodhimit për secilin mjet zjarrfikës aktualisht në përdorim.</p> <p>4.Numrin aktual të personelit zjarrfikës, si dhe numrin e punonjësve të rinj të rekrutuar nga vera 2025 deri më sot.</p> <p>5.Numrin e vendeve vakante dhe nevojën për personel sipas standardeve ligjore.</p> <p>6.Masat konkrete të ndërmarra pas sezonit veror 2025 për përmirësimin e shërbimit zjarrfikës (blerje pajisjesh, trajnime, investime infrastrukturore, etj.).</p> <p>7.Buxhetin e alokuar për shërbimin zjarrfikës për vitet 2024–2026, si dhe shpenzimet konkrete të kryera për mjete, pajisje dhe personel.</p> <p>8.Numrin e rasteve të ndërhyrjes gjatë vitit 2025 dhe 2026, si dhe kohën mesatare të reagimit.</p> <p>9.Çdo akt administrativ, vendim apo plan masash të miratuar pas sezonit veror</p>	09.04.2026	<p>1.Renault, 1.5 ton ujë, funksionale.</p> <p>MAN, 2 ton ujë, funksionale.</p> <p>Renault, 3 ton ujë, funksionale.</p> <p>Benz (shkallë), 15 m lartësi, jofunksionale, (kërkon riparim).</p> <p>2.Nga vera 2025 deri më sot, është shtuar një mjet zjarrfikës ( Renault 2025, 3 ton ujë), ndërsa në proces blerjeje ose prokurorimi nuk ka.</p> <p>3.Renault 1992 MAN 1975 Renault 2014</p> <p>4.Numri aktual i punonjësve është 14, ndërsa punonjës të rinj të rekrutuar nga vera 2025 deri më sot është 2.</p> <p>5.Aktualisht nuk ka vende vakante në shërbimin zjarrfikës të Bashkisë Belsh. Megjithatë, për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit, paraqitet nevoja për shtimin e personelit sipas standardeve ligjore.</p> <p>6.Masat e ndërmarra pas sezonit veror janë: blerje e uniformave për punonjësit, shtimi i një mjeti zjarrfikës, mirëmbajtje e mjeteve ekzistuese, përmirësim i</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>2025 për forcimin e kapaciteteve të shërbimit zjarrfikës.</p>		<p>gatishmërisë operacionale të shërbimit.  7.Viti 2024 - 18 773 916 lekë  Viti 2025 - 20 947 780 lekë  Viti 2026 - 21 633 608 lekë  8.Gjatë vitit 2025 janë realizuar 83 ndërhyrje. Gjatë vitit 2026 (deri në momentin aktual) janë realizuar 17 ndërhyrje. Koha mesatare e reagimit ndaj rasteve emergjente është e menjëhershme.  9.Pas sezonit veror 2025, janë ndërmarrë dhe parashikuar masa për përmirësimin e shërbimit zjarrfikës, si më poshtë:  Përmirësimi i flotës së mjeteve zjarrfikëse.  Shtimi i pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse.  Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet rekrutimeve të reja.  Përmirësimi i kushteve të punës dhe gatishmërisë operacionale.  Gjithashtu, janë në proces planifikimi masa të mëtejshme për rritjen e efikasitetit dhe forcimin e kapaciteteve të shërbimit në përballimin e emergjencave.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

04	09.04.2026	<p>1.Veprimet e ndërmarra deri më sot për realizimin e masave dhe rezultatet e tyre;</p> <p>2.Afatet e zbatimit dhe planet për implementim në të ardhmen;</p> <p>3.Burimet financiare të planifikuara dhe/ose të përdorura;</p> <p>4.Vështirësitë e mundshme të hasura gjatë procesit të implementimit dhe mënyrën se si po adresohen ato.</p>	15.04.2026	<p>-Në lidhje me zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ (2021–2027), deri më tani, nga ana e Bashkisë nuk janë ndërmarrë masa specifike në këtë drejtim, për shkak se nuk kemi pasur raste të deklaruara apo të identifikuar të personave që i përkasin këtij komuniteti dhe që kanë kërkuar mbështetje pranë institucionit tonë.</p> <p>-Megjithatë, Bashkia është e angazhuar që në kuadër të planifikimit të ardhshëm strategjik dhe buxhetor të përfshijë masa që lidhen me barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.</p> <p>-Një nga vështirësitë kryesore mbetet mungesa e rasteve të raportuara apo e të dhënave konkrete në nivel vendor.</p> <p>Megjithatë, në rast të identifikimit të rasteve në nevojë, Bashkia do të marrë masa përkatëse për mbështetje dhe ndërgjegjësim nëpërmjet fushatave sensibilizuese dhe shërbimeve përkatëse.</p> <p>-Mbetemi të hapur për bashkëpunim dhe përmirësim të mëtejshëm në këtë drejtim.</p>	E plotë	Pa pagesë
----	------------	--	------------	--	---------	-----------

05	14.04.2026	<p>1.A ka miratuar Këshilli Bashkiak një rregullore specifike për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median?</p> <p>2.Nëse po, ju lutemi ta vendosni këtë rregullore në dispozicion në mënyrë elektronike, duke specifikuar gjithashtu numrin dhe datën e vendimit me të cilin është miratuar.</p>	15.04.2026	<p>-Aktualisht, Këshilli Bashkiak nuk ka miratuar një rregullore specifike të veçantë që rregullon në mënyrë të dedikuar marrëdhëniet me publikun dhe median.</p> <p>-Megjithatë, funksionimi i Këshillit Bashkiak dhe komunikimi me publikun realizohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me aktet e përgjithshme rregullatore që garantojnë transparencën dhe të drejtën për informim.</p> <p>-Në rast se në të ardhmen do të miratohen akte të posaçme në këtë drejtim, ato do të bëhen publike sipas procedurave ligjore në fuqi.</p>	E plotë	Pa pagesë
----	------------	---	------------	--	---------	-----------

06	24.04.2026	<p>1.Sa eshte sasia totale e mbetjeve drusore qe gjenerohen nga bashkia ne vit (per shembull per vitin 2025, ne ton)?</p> <p>2.Nga se perbehen keto mbetje dhe cilat jane burimet kryesore?</p> <p>3.Si jane keto mbetje te shperndara sipas zonave (urbane/rurale)?</p> <p>4.Si behet grumbullimi i mbetjeve drusore dhe cfare ndodh me to pasi mblidhen? A ndonje forme trajtimi aktuale?</p> <p>5.Sa jane nevojat vjetore te bashkise per produkte drusore (p.sh. dru zjarri, paleta, etj.) per vitin 2025?</p> <p>6.Si realizohen keto blerje (tendera, forma te tjera)?</p> <p>7.Kur zakonisht zhvillohen keto procedura (periudha e vitit)?</p> <p>8.Nese eshte e mundur, a mund te ndani nje cmim mesatar/reference per keto produkte?</p>	28.04.2026	<p>1.Sasia totale e mbetjeve drusore e gjeneruar nga bashkia gjate vitit 2025 eshte 14.7 ton.</p> <p>2.Keto mbetje jane te shperndara sipas zonave (urbane/rurale) si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zona urbane 3.528 ton.</li> <li>- Zona rurale 11.172 ton.</li> </ul> <p>3.Pasi grumbullohen keto mbetje dergohen ne fushen e kompostimit, ku prapunohen dhe kthehen ne pleh organik.</p> <p>4.Ndersa persa i perket blerjeve te produkteve drusore gjate vitit 2025, bashkia nuk ka bere blerje te tilla pasi nevojat e bashkise per produkte drusore jane mundesuar nga rrallimi i pyjeve ne zone. Ne vitin 2025, ne shkolla jane shperndare 60 m3 dru.</p>	E plotë	Pa pagesë
07	24.04.2026	<p>1.Sa eshte sipërfaqja totale e tokave që u janë dhënë kompanive private për ndërtimin e paneleve/parqeve diellore fotovoltaike dhe eolike në territorin e Bashkisë?</p> <p>2.Na vini në dispozicion një kopje të kontratës dhe të dhënat që përcaktojnë sipërfaqen e dhënë për çdo kompani, vendodhjen gjeografike, emrin e kompanisë përfituese.</p> <p>3.Kopje të kontratave apo vendimeve përkatëse që autorizojnë përdorimin e këtyre tokave për energji të rinovueshme?</p>	04.05.2026	<p>1.Sa i përket sipërfaqes totale të tokave të dhëna me qira për ndërtimin e paneleve/parqeve fotovoltaike dhe eolike, Bashkia Belsh nuk ka dhënë asnjë sipërfaqe toke me qira për kompani private për këtë qëllim. Për rrjedhojë, sipërfaqja totale është 0 (zero).</p> <p>2.Lidhur me kopjet e kontratave dhe të dhënat përkatëse (sipërfaqe, vendndodhje, emër kompanie), ju bëjmë me dije se Bashkia Belsh nuk ka lidhur kontrata për dhënie në përdorim të tokave për energji të rinovueshme. Për pasojë,</p>	E plotë	Pa pagesë

				<p>nuk disponohen kontrata apo të dhëna të tilla. 3.Sa i përket kopjeve të kontratave apo vendimeve që autorizojnë përdorimin e këtyre tokave, ju sqarojmë se Bashkia Belsh nuk ka marrë vendime dhe nuk ka lidhur kontrata për dhënien me qira apo në përdorim të tokave për këtë qëllim.</p>		
--	--	--	--	--	--	--